



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 27/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Goran Milenković - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “NTP Prima Engineering” – Prishtinë, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit “Hartimi i hartës zonale për komunën e Prizrenit”, me nr prok: “622/16/109/421”, të iniciuar nga KK-Prizren, më datën 16 shkurt 2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE “NTP Prima Engineering” – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i hartës zonale për komunën e Prizrenit” me nr prok: “622/16/109/421”, iniciuar nga autoriteti kontraktues KK-Prizren.
- II. **Anulohet**, njoftimi për anulim i AK-së /Komuna Prizren /, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i hartës zonale për komunën e Prizrenit”, me nr prok: “622/16/109/421” dhe lënda të kthehet ne **Rivlerësim**.
- III. Operatorit ekonomik ankues, konform nenit 118.3 të LPP-së i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës, pasi që ankesa aprovohet si e bazuar.
- IV. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

- V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë është bërë me dt:29.08.2016, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt:26.09.2016, ndërsa në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë pesë operatorë ekonomik.

Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:19.01.2016.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik NTP “Prima Engineering”-Prishtinë është bërë me dt:20.01.2017.

Vendimi në lidhje me kërkesën për rishqyrtim është marr me dt:23.01.2017, ku i është refuzuar kërkesa për rishqyrtim.

Operatori ekonomik NTP“Prima Engineering” – Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datën 25 janar 2017 me nr. protokolli 27/17, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit: “Hartimi i hartës zonale për komunën e Prizren” me nr prok “622/16/109/421” duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminim
- Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe K rahasimi i Tenderëve
- Vendimi i OSHP-së: PSH.408/16, i datës 30.12.2016

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Ekspertët shqyrtues-teknik përmes raportit të datës 10 shkurt 2016, bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë, ka propozuar panelit shqyrtues që të anulohet vendimi Autoritetit

Kontraktues- “Komuna Prizrenit”, për aktivitetin e prokurimit: “Hartimi i hartës zonale për komunën e Prizrent” me nr prok “622/16/109/421”, dhe lënda të kthehet ne **Rivlerësim** ndërsa ankesa OE NTP “Prima Engineering”, të aprovohet si e **bazuar**.

Operatori ekonomik ankues me datë 11 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues me datë 10 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 22.12.2016, të mbajtur pa praninë e palëve konform nenit 28 paragrafi 1 i të rregullores së punës së OSHP-së, kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues deklarojë: qëndrojë në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës 10.02.2017

Paneli shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, ekspertizës së ekspertit shqyrtues, si dhe të gjitha argumenteve dhe fakteve relevante, sqaron se autoriteti kontraktues fillimisht ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik “Smart Project” me çmim prej 186,000.00 €. Pas rekomandimit për kontratë të këtij operatori ekonomik, është deponuar ankesë në OSHP nga OE “Prima Engineering” me nr.408/16, e më ç’rast i është aprovuar ankesa si e bazuar pjesërisht dhe lënda është kthyer në rivlerësim. Pas rivlerësimit autoriteti kontraktues e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin se *“të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime të cilat në mase substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; OE Smart Project, Prima ingineering, Diarko dhe Hidroing DK kanë çmime ofertuese më të larta se 120.000,00 € ndërsa tenderi është shërbim vlerë e mesme, ndërsa OE AB KONS në vlerësimin teknik nuk ka marr 70% të 70 poenave që i bie 49 poena por ka marr 44.33 poena gjë që e bën edhe këtë të pa përgjegjshëm”*.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk është bazuar në asnjë dispozitë të Ligjit për Prokurim Publik, ndërsa në nenin 62 paragrafi 2.1 një ndër arsytet e anulimit të aktivitetit të prokurimit është se *“të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK-së për aktivitetin e prokurimit”*. Kjo arsye e eliminimit është e shënuar edhe në nenin 44.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik. Pra arsye e anulimit mund të jetë nëse tejkalohet buxheti i AK-së, e jo arsye sikurse në këtë rast që e ka dhënë autoriteti kontraktues se kjo procedurë është shërbim me vlerë të mesme. Duke u bazuar në deklaratën e fondeve dhe të disponueshmërisë së mjeteve rezulton se për

këtë projekt kanë qenë të planifikuara dhe të parashikuara 185,000.00 €, e që kjo deklaratë është e nënshkruar nga të gjithë personat kompetentë sipas dispozitave të LPP-së.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues ka përdorur standarde të dyfishta gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit, pasi që fillimisht ka rekomanduar për kontratë OE “Smart Project” që ka pas çmimin prej 186,000.00 €, e që rezulton se ky OE e kishte tejkaluar vlerën e parashikuar për njëmijë euro, ndërsa tani e anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin e pabazuar se të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime të cilat në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues edhe pse duke u bazuar në procesverbalin e hapjes vërehet se të gjithë ofertuesit tjerë nuk tejkalojnë vlerën e parashikuar të kontratës sipas deklaratës së disponueshmërisë së mjeteve, përveç operatorit ekonomik që është rekomanduar për kontratë herën e parë “Smart Projekt”, e i cili është konsideruar se nuk i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së sipas vendimit të OSHP-së Nr.408/16 i dt:30.12.2016.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se arsyeja e dhënë nga autoriteti kontraktues për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit nuk është e parashikuar në nenin 62 të LPP-së apo me ndonjë dispozitë tjetër ligjore të legjislacionit sekondar, kështu që autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me vendimin e OSHP-së, PSH.Nr 408/16 të dt:30.12.2016.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “Komuna Prizren”

1x1 NTP “Prima Engineering” – Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në Web- faqe të OSHP-së.

